

Informacioni juaj

Është i fshehtë

Çfarë ndodhë me informacionin tuaj gjatë kohës që ju jeni konsumues i këtij shërbimi?

Kush jemi ne?

Ne jemi një prej disa shërbimeve të kujdesit të shëndetit dhe komunitetit në zonën tuaj, dhe të gjithë punojmë së bashku në shoqëri për tu përgjigjur kërkesave tuaja shëndetësore.

Çfarë informacioni rreth jush mbledhim?

Në rekordin tuaj të konsumatorit ne mbajmë emrin tuaj dhe detajet për kontakt. Hollësira tjera siç janë plani mbi kujdesjen tuaj dhe informacioni mbi shëndetin tuaj shënohen në çdo vizitë që bëni.

Përse mbledhim informacionin tuaj?

Informacioni që ne mbledhim na ndihmon të mbajmë të dhënat aktuale në lidhje me nevojat tuaja, dhe kjo na ndihmon që të kujdesemi sa më mirë që është e mundur për ju. Po ashtu informacionin e shfrytëzojmë që të drejtojmë dhe planifikojmë sa më të mirë këtë shërbim.

Kush tjetër shikon informacionin tuaj?

Informacioni juaj mund të shikohet vetëm nga profesionistët në këtë shërbim që janë të angazhuar me përkujdesjen tuaj. Përndryshe ne japim informacion në lidhje me ju vetëm me pëlqimin tuaj ose nëse kërkohet me ligj, siç është rasti me urgjencën mjekësore.

A keni pyetje të tjera?

Ju lutemi të kërkoni të bisedoni me një nga punonjësit tonë nëse keni pyetje të tjera ose vërejtje në lidhje me çfarë ndodh me informacionin tuaj në kohën që jeni konsumatori jonë, ose nëse dëshironi të shikoni të dhënat tuaja.

A mund ta shprehni mendimin tuaj se ç'është me informacionin tuaj?

Keni të drejtë ta shprehni mendimin se çfarë bëhet me informacionin tuaj. Ne mbështetemi në informacionin që na jepni ju që të na ndihmojë të japim kujdesin e duhur për ju. Nëse ju vendosni që të mos ti jepni disa prej të dhënave ose kufizoni hyrjen në shënimet e konsumatorit, kjo është e drejta e juaj, por kjo mund të ndikojë në aftësitë tona që t'ju ofrojmë shërbimin më të mirë të mundshëm. Bisedoni me ne nëse dëshironi ta ndërroni ose anuloni pëlqimin tuaj.

Si ruhet informacioni juaj?

Ne marrim përsipër të mbrojmë fshehtësinë e shënimeve tuaja. Fshtësia e informacionit tuaj është e mbrojtur edhe me ligj. Informacionin tuaj ne e trajtojmë në fshtësi të plotë dhe e ruajmë në mënyrë të sigurtë.

A mund të keni hyrje në të dhënat tuaja?

Po, ju keni të drejtë të kërkoni hyrje në të dhënat tuaja dhe të kërkoni korigjimin e tyre, nëse është e nevojshme.